

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

"ÇOBA BAKERY" SHPK

Ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar si dhe te Ligjit 9723, date 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, Ligjit nr 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", ne :

- 1- **Ela Çoba**, shtetase shqiptare lindur më 05.03.1987, lindur në Laç, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I75505155I madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 2- **Elton Çoba**, shtetas shqiptar lindur më 07.03.1980, lindur në Selitë, Krujë, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I00307082J madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

shpallim si me poshte vijon:

Neni 1

Sot me 14/12/2022, Themelohet shoqeria e quajtur "**ÇOBA BAKERY**" SHPK me ortakë :

- 1- **Ela Çoba**, shtetase shqiptare lindur më 05.03.1987, lindur në Laç, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I75505155I madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- 2- **Elton Çoba**, shtetas shqiptar lindur më 07.03.1980, lindur në Selitë, Krujë, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I00307082J madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Neni 2

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën :Lagjja nr.3, Rruga Bulevardi Martirët e Lirisë, Ndërtesë 3 katëshe, Kati 1, Zonë Kadastrale nr.2364, me Pasuri nr.3/210,Laç,Lezhë.

Shoqeria mund te themeloje dege dhe filiale ne te gjithë territorin e vendit si dhe jashte tij me miratimin e organeve kompetente dhe ne perputhje me legjislacionin e vendit ku do te hapen keto agjensi.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

Të zhvilloj aktivitetet në fushën e prodhimit, shpërndarjes dhe tregtimit të produkteve ushqimore prej brumi: si bukë të llojeve të ndryshme, byreqe, pite e ëmbëlsira të llojeve të ndryshme.

Të tregëtoj pije freskuese dhe alkoolike të llojeve të ndryshme.

Të hapi furrë buke, punishte brumi dhe ëmbëlsirash, bare dhe restorante, si dhe shërbime të tjera të lidhura me to.

Në funksion të arritjes së objektivave Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm."

Kapitali i regjistruar i shoqërisë përbëhet nga **dy kuota prej 2.000.000 lekë (dymilion), dhe është kontribut i Ortakëve :**

- 1. Ela Çoba, një kuotë në masën 50 % të vlerës absolute të kapitalit ose 1 000 000 lekë.**
- 2. Elton Çoba, një kuotë në masën 50 % të vlerës absolute të kapitalit ose 1 000 000 lekë.**

Ortakët e shoqërisë mund të vendosin për rritjen apo zvogëlimin e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

Detyrimet e çdo ortaku kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesën e kapitalit të derdhur nga ai. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortaku nuk mban përgjegjësi.

Neni 6

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj të cilat janë:

1. Asambleja e Përgjithshme.
2. Administratoret

Shoqëria ka si ortakë:

- Ela Çoba
- Elton Çoba



dhe administrator me afat emërimi 5 vjeçar :

- 3- **Ela Çoba**, shtetase shqiptare lindur më 05.03.1987, lindur në Laç, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I75505155I madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Menyra dhe drejtimi i shoqërisë janë të percaktuara në Statutin e shoqërisë.

Neni 7

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë perhapjen e tyre gofite dhe pjesërisht.

Neni 8

Në se shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrojë një bilanc likuidimi për miratim.

Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhet me mirëkuptim dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, çështja do t'i kalojë për gjykim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

ORTAKËT E SHOQËRISË "ÇOBA BAKERY" SHPK

Ela ÇOBA

Ela Çoba



Elton ÇOBA

ELTON ÇOBA

